

## **Kriteret dhe specifikimet e ambientit**

1. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC) kërkon të marrë me qira ambient të përshtatshëm për **zyra për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit** me këto kriteret dhe specifikime si më poshtë vijon:

- a) Ambienti duhet të ketë kushte sigurie (sistem sigurie, sistem kundër zjarrit);
- b) Të ketë tualete (4 minimumi ne rast se sipërfaqja është ne me shume se 1 kat), ujë dhe energji elektrike në kushte optimale;
- c) Ambienti duhet të ketë rreth 800 m<sup>2</sup> sipërfaqe në total dhe lartësi mbi 260 cm;
- d) Ndriçim artificial dhe natyral të nevojshëm;
- e) Aspirim artificial ose natyral;
- f) Ambientet të jenë të përshtatshme për zyra;
- g) Shpërndarja vertikale e ambienteve te jete minimumi ne 1 kat dhe maksimumi ne 4 kate brenda te njëjtës godine.
- h) Ambienti të mundësojë hapësirë për parkim automjeteve (minimumi 2 vende);
- i) Kondicionim;
- j) Rrjet elektrik të përshtatshëm për pozicione pune publike;
- k) Të mos ketë detyrime të prapambetura (të energjisë elektrike, ujë);

## **2. Dokumentacioni i ofertës ekonomike duhet të përmbajë:**

- Oferta e qiradhënësit që specifikon sipërfaqen dhe çmimin mujor (ne LEKË) të qerasë për m<sup>2</sup> sipërfaqe;
- Gent-plani i pasurisë;

## **3. Dokumentacioni kualifikues do të jetë:**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e qiradhënies, në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”;
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv);
- c) nuk është dënuar për shkelje penale;
- d) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- e) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) Deklaratë mbi konfliktin e interesit;

- g) Vetëdeklarim mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik;
- h) Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit nga Administrata Tatimore;
- i) Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, ujit;
- j) Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore;
  
- k) Vetëdeklarim që subjekti e zotëron pronën në mënyrë ligjore.

Subjekti i cili do të shpallet fitues do të paraqesë dokumentacionin provues ligjor përpara lidhjes së kontratës.

Dokumentacioni i sipërcituar duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

- 4. Dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jetë i futur në një zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën tuaj. Mbi zarf duhet të jetë shënuar ofertë për marrje me qira ambient zyresh për ushtrimin e veprimtarisë së Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC).
- 5. Qiradhënësi duhet të dorëzojë ofertën brenda 6 (gjashtë) ditësh pune nga dita e marrjes së njoftimit për shprehje interesi.
- 6. Qiradhënësi duhet të pranojë që pagesa e qerave të bëhet çdo muaj në leke, bazuar në cmimin e ofruar dhe sanksionuar në kontratën e qirasë, kundrejt lëshimit të faturës tatimore.

## **7. Kriteret Vlerësuese**

- a. Çmimi i ofruar (tarifa e qirasë për m<sup>2</sup> sipërfaqe);
- b. Vendndodhja e objektit;
- c. Përmbushja e kërkesave, kushteve dhe kriterëve të vendosura ;
- d. Zgjidhja arkitektonike e propozuar (planvendosja), gjendja fizike e ambienteve dhe cilësia e shërbimeve për këto ambiente.